




Co-funded by
the European Union



german
cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Udhëzime për produktet e makinerive

Zbatimi i Direktivës për makineritë (2006/42/EC)



Implemented by

giz

Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Tabela e përmbajtjes

1. Shkurtesat	4
2. Si të dizajtojmë përshtatjen e makinerisë (metoda me tre hapa)?	5
2.1 Pasqyrë e përgjithshme	5
2.1.1 Hapi i parë: Dizajn në thelb i sigurt	7
2.1.2 Hapi i dytë: Mbrojtëset dhe pajisjet e sigurisë	8
2.1.3 Hapi i tretë: Informacion për përdorim	8
2.2 Adresimi i kriterëve thelbësorë	9
2.3 Mbrojtëset dhe pajisjet e sigurisë	10
2.4 Sistemi i kontrollit	10
2.5 Pajisjet elektrike të makinerive	12
2.6 Kriteret e tjera kryesore të sigurisë	13
2.6.1 Zjarri dhe shpërthimi	13
2.6.2 Zhurma dhe dridhja	13
2.6.3 Rrezatimi	13
2.6.4 Emetimi i ndotjes	14
2.6.5 Mirëmbajtja e makinerive	14
2.6.6 Makineritë mobile	14
2.6.7 Pajisje ngritëse	15
2.6.8 Pajisje ngritëse për persona	15
2.7 Vlerësimi i rrezikut	16
2.7.1 Vlerësimi i rrezikut	18
2.7.2 Identifikimi i rrezikut	20
2.7.3 Siguria funksionale e makinerisë (projektimi dhe vërtetimi)	21
2.7.4 Dallimi midis rrezikshmërisë dhe rrezikut	23
3. Roli i standardeve në dizajnin e makinave	24
3.1 Pasqyrë e përgjithshme	24
3.2 Llojet e standardeve	25
3.3 Struktura e standardit	27
3.4 Dokumentacioni teknik	28
3.5 Sistemet e integruara të prodhimit	30
3.6 Deklarimi i konformitetit	31
3.7 Udhëzime për përdorim	32
4. Vlerësimi i konformitetit të makinerisë	33
4.1 Pasqyrë e përgjithshme	33
4.2 Ekzaminimi i llojit të makinerive me rrezik të lartë (moduli B)	35
4.3 Sistemi i sigurimit të plotë të cilësisë	36
4.4 Kontrolli i brendshëm i prodhimit	37
4.5 Pajisjet e testimit për vlerësimin e pajtueshmërisë	38
5. Udhëzime të tjera mbi procedurën e njoftimit të organeve të përcaktuara për makineritë (bazuar në EA 2-17:2020) në BE	39
6. Bibliografi	45

1. Shkurtesat

Shkurtesë	Shpjegim
ATEX	Direktiva për Pajisjet që do të Përdoren në Atmosferë Potencialisht Shpërthyesë
OVK	Organ për Vlerësim të Konformitetit
CEFTA	Marrëveshje e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
CEN	Comité Européen de Normalization / Komiteti evropian për standardizim
CENELEC	Comité Européen de Normalization Électrotechnique / Komiteti evropian për standardizim elektroteknik
KONj	Koordinim i Organeve të Njoftuara
KONj/M	Koordinim i Organeve të Njoftuara për Makineri
EA	Bashkëpunimi Evropian për Akreditim
EHSR	Kriteret Thelbësore për Shëndetin dhe Sigurinë
MSh	Mjedis Shpërthyes
BE (KE)	Bashkimi Evropian (Komuniteti Evropian)
SIP	Sistemi i Integruar i Prodhimit
MD	Direktiva e Makinerisë 2006/42/EC
NANDO	Qasje e re e Organizatave të Njoftuara dhe të Përcaktuara
ONj	Organi i Njoftuar
KRL	Korniza e Re Legjislative
ZHURMA	Direktiva për Emetimin e Zhurmës së Pajisjeve të Jashtme
PED	Direktiva për Pajisjet nën Presion
NP	Niveli i Performancës
PPM	Pajisje Personale Mbrojtëse
IC	Infrastruktura e Cilësisë
DTN	Dosja Teknike e Ndërtimit

Shënim: Ky udhëzues është përgatitur për një kuptim më të mirë të zbatimit të Direktivës së makinerisë nga operatorët ekonomikë, por edhe nga palët e tjera të interesit të IC. Kapitujt 1 dhe 2 janë të destinuar kryesisht për prodhuesit, ndërsa kapitujt 3 dhe 4 janë të destinuara për OVK që operojnë në sektorin e makinerive.

2. Si të dizajtojmë përshtatjen e makinerisë (metoda me tre hapa)?



2.1 Pasqyrë e përgjithshme

Në Direktivën e makinerisë parashihet që Kriteret Thelbësore të Shëndetit dhe Sigurisë (EHSR) në lidhje me makinën në fjalë të plotësohen sipas një renditjeje trehapëshe masash për reduktimin e rrezikut. Kriteret janë shkruar në gjuhë të thjeshtë dhe ligjore pa dhënë ndonjë udhëzim teknikisht specifik për plotësimin e tyre. Kjo ngritë një pyetje legjitime se si t'i qasemi këtyre kriterëve dhe cilat janë marrëdhëniet midis EHSR-ve, rreziqeve dhe masave të standardeve të harmonizuara.

Trajtimi i sigurt në të gjitha ciklet e jetës së makinerive (transporti, montimi, fillimi, përdorimi, mirëmbajtja dhe çmontimi) mund të sigurohet kur zbatohen parimet e projektimit të makinerive të sigura siç përshkruhet në standardin EN ISO 12100 - Siguria e makin-

erive - Parime të përgjithshme për projektim — Vlerësimi i rrezikut dhe reduktimi i rrezikut.

Këto pyetje zakonisht lindin për projektuesin:


- 01.** Si mund t'i qasem dizajnimin të një makinerie në mënyrë të organizuar në mënyrë që të mos mbetet ndonjë kriter i EHSR i paplotësuar?
- 02.** si mund të vlerësoj kur rreziqet për shkak të rrezikut aktual ose situatave të rrezikshme duhet të zbutet përmes masave të sigurisë?
- 03.** si mund të jem i sigurt se masat e sigurisë të aplikuara në formën e një dizajni ose mbrojtjeje në thelb të sigurt janë të sakta dhe të mjaftueshme?

Në thelb ekzistojnë dy mënyra të ngjashme për të marrë parasysh në mënyrë gjithëpërfshirëse EHSR-të në procesin e projektimit. Njëra është ndjekja hap pas hapi e listës së kritereve nga Shtojca I, ndërsa tjetra (më shpesh e përdorur dhe transparente) është një proces i përcjelljes së kritereve nëpërmjet identifikimit të rreziqeve, vlerësimit të tyre dhe zbatimit të masave për zbutjen e rrezikut përmes tre hapave. Kur masat për zbutjen e rrezikut janë në përputhje me standardet e harmonizuara, ato automatikisht japin supozimin e konformitetit me Direktivën e makinerisë.

Por çfarë do të thotë saktësisht një mënyrë me tre hapa në projektimin e një makine të përputhshme?

Do të thotë që dizajni i një makinerie të sigurt duhet të ndjekë tre hapa të njëpasnjëshëm:

- 1. Hapi** masat për dizajn të sigurt në thelb,
- 2. Hapi** përzgjedhja dhe projektimi i pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse dhe të sigurisë,
- 3. Hapi** udhëzime për përdorim.



Parimet e zbutjes së rrezikut në një nivel të pranueshëm përmes masave të marra nga projektuesi dhe përdoruesi (sipas EN ISO 12100).

2.1.1

Hapi i parë: Dizajn në thelb i sigurt

Në hapin e parë, projektuesi duhet të përpiqet të eliminojë rreziqet sa më shumë që të jetë e mundur në funksion të përdorimit të synuar të makinës me kufizimin e ekspozimit të personave, për shembull: përzgjedhja dhe vendosja e aktiviteteve të nevojshme të operatorit dhe stacioneve të punës, përzgjedhja e numrit të operatorëve dhe aftësive të tyre, automatizimi dhe mekanizimi i operacioneve të caktuara të makinerive, përdorimi i teknologjisë së informacionit për monitorim, etj. Dizajni në thelb i sigurt do të përftohet më tej nga:

- 01.** Marrja parasysh e faktorëve gjeometrikë dhe aspekteve fizike (sigurimi i dukshmërisë së stacioneve të punës dhe monitorimi i proceseve të makinës pa pengesa, qasshmëria dhe logjika e sistemit të kontrollit, kufizimi i masave dhe shpejtësive të elementeve të lëvizshëm, reduktimi i emetimeve të çdo lloji, shmangia e skajeve të mprehta, aplikimi i distancave të sigurisë etj.);
- 02.** Marrja parasysh e njohurive të përgjithshme teknike në lidhje me dizajnin e makinës (kodet e projektimit dhe rregullat e llogaritjes për elementët dhe strukturat bazë në lidhje me ngarkesën e parashikueshme të përdorimit, mbishfrytëzimin dhe keqpërdorimin e parashikueshëm) së bashku me informacionin për materialet dhe substancat e punës të inkorporuara;
- 03.** Zgjedhja e një teknologjie të përshtatshme duke përfshirë furnizimin me energji;
- 04.** Zbatimi i parimit të veprimit mekanik pozitiv të një komponenti në një komponent tjetër;
- 05.** Dispozitat për qëndrueshmëri (gjeometria e bazës, shpërndarja e peshës, forcat dinamike dhe lëkundjet, ndikimi i forcave të jashtme si presioni i erës);
- 06.** Dispozitat për mirëmbajtjen (qasja në pjesët e makinerisë që kanë nevojë për mirëmbajtje, lehtësia e trajtimit, masat paraprake të sigurisë);
- 07.** Respektimi i parimeve ergonomike (përshtatja me të dhënat antropometrike të njeriut dhe ngarkesa fizike në punë);
- 08.** Parandalimi i rrezikut elektrik (dispozitat e përgjithshme janë paraparë në EN 60204-1);
- 09.** Parandalimi i rreziqeve nga pajisjet hidraulike dhe pneumatike (kufizimi i presioneve, elementet e sigurisë për mbipresion, etj.);
- 10.** Zbatimi i masave në thelb të sigurta të projektimit në sistemin e kontrollit (dispozitat e përgjithshme janë paraparë në EN ISO 13849-1 si parandalimi i ndezjes së papritur, rinisja pas ndërprerjes së energjisë, ndryshimi i pakontrolluar i shpejtësisë, dështimi në ndalim, aspektet harduerike dhe softuerike, etj.);
- 11.** Minimizimi i rreziqeve për shkak të dështimit të funksioneve të sigurisë (tepricë dhe monitorim i qarqeve të kontrollit);
- 12.** Minimizimi i probabilitetit të dështimit të funksioneve të sigurisë;
- 13.** Kufizimi i ekspozimit ndaj rreziqeve nëpërmjet mekanizimit ose automatizimit të operacioneve të ngarkim-shkarkimit.

2.1.2

Hapi i dytë: Mbrojtëset dhe pajisjet e sigurisë

Kur dizajni në thelb i sigurt nuk mund të arrihet për shkak të kufizimeve të funksionalitetit ose natyrës së proceseve të punës, projektuesi duhet të kërkojë masat e duhura të sigurisë brenda hapit të dytë - pajisjet mbrojtëse dhe të sigurisë. Përzgjedhja dhe performanca e tyre do të kontrollohen sërish nga vlerësimi i rrezikut. Si më parë, përsëri rekomandohet përdorimi i standardeve të harmonizuara. Udhëzime më të detajuara jepen më tej në këtë dokument.

2.1.3

2.1.3 Hapi i tretë: Informacion për përdorim

Kur, pas aplikimit të masave teknike, rreziqet e mbetura në makinë ekzistojnë ende, projektuesi duhet të përcjellë rreziqet e mbetura përmes informacionit për të paralajmëruar përdoruesit për rreziqet e mbetura. Komunikimet audio-vizuale të disponueshme janë:

- 01.** Sinjalet dhe pajisjet paralajmëruese,
- 02.** Paralajmërimet dhe piktogramet (shenjat grafike të standardizuara sipas ISO 7000),
- 03.** Paralajmërimet e sigurisë në udhëzimet për përdorim lidhur me rreziqet e mbetura (manual, doracak).

Prodhuesi duhet të paralajmërojë përdoruesin për rreziqet e mbetura, të përcaktojë Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM) për punë të sigurt me makinën dhe, sipas rastit, të trajnojë përdoruesin për punë të sigurt. Përdoruesi është përgjegjës për përdorimin

dhe mirëmbajtjen e makinës në përputhje me udhëzimet e prodhuesit për përdorim. Në asnjë rast udhëzimet për përdorim nuk mund të zëvendësojnë masat e hequra për një dizajn të sigurt në thelb, nëse këto masa janë teknikisht të mundshme për t'u realizuar më vonë, sepse masat e sigurta të projektimit japin një nivel më të lartë sigurie për shkak të pavarësisë së tyre nga aftësitë psikofizike të përdoruesit, si dhe mundësisë më të vogël për të anashkaluar masat e sigurisë.

Për të kontrolluar nëse procesi i vlerësimit të rrezikut ka marrë parasysh të gjitha çështjet e lidhura me sigurinë, një prodhues mund të kontrollojë gjithashtu nëse EHSR e zbatueshme nga Shtojca I e Direktivës së makinerisë është përmbushur. Kjo është veçanërisht e dobishme për makineritë industriale ose makinat e njëhershme ku nuk ekziston asnjë standard produkti.



Piktogramet paralajmërojnë përdoruesin për rreziqet e mbetura, praktikat e sigurta dhe/ose përdorimin e PPM

2.2 Adresimi i kriterëve thelbësorë

EHSR-të në MD janë të organizuara ndryshe dhe janë grupuar në gjashtë kapituj sipas natyrës së rreziqeve që ato mbulojnë (qasja taksonomike). Kapitulli i parë do të përdoret për çdo lloj makinerie, ndërsa kapitujt e tjerë mbulojnë lloje të veçanta makinerish. Shtatë kriteret kryesore në kapitullin e parë i referohen:

- 01.** Kriterëve të përgjithshme (klauzola 1.1): përcakton terminologjinë dhe jep udhëzime se si të garantohet siguria duke përdorur procedurën e pajtueshmërisë me tre hapa për të arritur qëllimin, dmth. nivel të pranueshëm nëpërmjet përdorimit të mbrojtjes dhe informacionit për përdoruesit;
- 02.** Kriterëve për sistemet e kontrollit (klauzola 1.2): fillimi, ndalimi, ndalimi emergjent, zgjedhja e modalitetit, softueri;
- 03.** Mbrojtjes kundër rreziqeve mekanike (klauzola 1.3): llojet e mbrojtjes, karakteristikat e mbrojtësve, ndërthurja;
- 04.** Përzgjedhjes së mbrojtësve dhe pajisjeve të sigurisë (klauzola 1.4): llojet dhe kushtet për përzgjedhje, karakteristikat e pajisjeve të sigurisë;
- 05.** Kriterëve për llojet e tjera të rreziqeve (klauzola 1.5): furnizimi me energji elektrike dhe pajisjet elektrike, mbrojtja nga zjarri dhe shpërthimi, zhurma dhe dridhjet, emetimi i substancave të rrezikshme, etj.;
- 06.** Kriterëve për planifikimin e aktiviteteve të sigurta të mirëmbajtjes në makinë

dhe performancën e saj të sigurt (klauzola 1.6);

- 07.** Shënjjimit (klauzola 1.7): pajisjet e informacionit, sinjalet, paralajmërimet për rreziqet e mbetura, pllakat e shënjjimit, informacioni për përdorim (manual).


Në pjesën e mëposhtme jepen qasjet themelore ndaj këtyre grupeve thelbësore të masave të sigurisë:

Kriteret e mëtejshme i referohen llojeve të ndryshme të makinerive ose rreziqeve specifike:

- 01.** Makineri për produkte agroushqimore, makineri portative me dorë dhe/ose të drejtuara me dorë, makineri për punimin e drurit dhe materialeve analoge, makineri portative fiksuese dhe goditjeje, makineri për aplikimin e pesticideve;
- 02.** Makineri mobile;
- 03.** Makineritë e funksionimit të ngritjes;
- 04.** Makineri pune nentoke;
- 05.** Makineri për ngritjen ose lëvizjen e personave;
- 06.** Udhëzime të përgjithshme për pajisjet mbrojtëse dhe të sigurisë.

2.3 Mbrojtëset dhe pajisjet e sigurisë

Mbrojtëset duhet të parandalojnë përdoruesit nga rreziqet mekanike që lindin në makinë. Mbrojtëset duhet të zgjedhen sipas natyrës së përdorimit të tyre (EN ISO 14120) dhe të projektohen për të ruajtur funksionin e tyre të sigurisë (distancat e sigurisë sipas EN ISO 13854 dhe EN ISO 13857).



Udhëzues për zgjedhjen e mbrojtës nga pjesët e lëvizshme (EN ISO 14120)

2.4 Sistemi i kontrollit

Logjika e sistemit të kontrollit të makinës dhe aspektit të sigurisë së saj është gjithashtu e standardizuar. Kriteret kryesore (si aktivizuesit e nevojshëm dhe funksioni i tyre) përshkruhen në disa nga EHSR-të. Megjithatë, rregullat e përgjithshme për projektimin dhe verifikimin e pjesëve të

lidhura me sigurinë të sistemit të kontrollit janë (kur nuk përcaktohen në standardin e tipit C) të përcaktuara në EN ISO 13849-1 dhe EN ISO 13849-2.

Përkatësisht, dështimi i njërit prej komponentëve të sistemit të kontrollit mund të shkaktojë funksionim të parregullt

të makinës duke shkaktuar një ngjarje të mundshme të dëmshme që mund të ndodhë. Në këtë çështje, sistemet e kontrollit duhet të projektohen dhe kontrollohen me kujdes që të funksionojnë siç duhet. Në bazë të vlerësimit të rrezikut, ekzistojnë pesë nivele bazë të performancës së sistemeve të kontrollit që kërkojnë arkitekturën e sistemit të kontrollit dhe karakteristikat e besueshmërisë. Në praktikë, nëse vlerësimi i rrezikut në lidhje me sistemin e kontrollit tregon rrezik të lartë për përdoruesin, projektuesi duhet të zgjedhë një sistem më të sofistikuar, ku funksioni i tij i duhur mund të jetë nën mbulim diagnostik në intervale të rregullta ose të ketë instalime elektrike të tepërta.

Pajisjet e sigurisë duhet të pozicionohen në lidhje me shpejtësinë e afrimit të pjesëve lëvizëse sipas EN ISO 13855. Distanca e sigurisë duhet të llogariten dhe pajisjet e duhura të zgjidhen si më poshtë:

$$S = (v \times t) + C$$

S...distanca minimale nga trupi në pikën e aktivizimit të pajisjes së sigurisë


v...shpejtësia e afrimit (në pjesë të trupit të njeriut)

t...koha totale e ndalimit


C...distanca shtesë

Pajisjet e sigurisë të njohura gjerësisht janë (për të renditur disa prej tyre):

- 01.** Ndalesa emergjente (g);
- 02.** Pajisje kontrolli me dy duar (f);
- 03.** Mbrojtëse e ndërthurur me mbyllje mbrojtëse (b);
- 04.** Vonesa kohore (c);
- 05.** Pajisje të ndjeshme elektrooptike (a);
- 06.** Dyshekë presioni (e);
- 07.** Ndërprerësit e kufizimit (h).



Llojet e pajisjeve të sigurisë (fragment nga standardi i mëparshëm i lidhur EN 953)



Udhëzues për zgjedhjen dhe pozicionimin e pajisjeve të sigurisë (EN ISO 13855)

2.5 Pajisjet elektrike të makinerive

Standardi EN 60204-1 jep udhëzime për projektimin e qarqeve elektrike. Në këtë standard përcakohen kriteret për sistemet e kontrollit, mbrojtja nga prekja (jo)direkte e pjesëve të gjalla, mbrojtja nga mbirryma, qarku i shkurtër, mbinxehja, ndezja e papritur pas rivendosjes së furnizimit me energji dhe dështimi i lidhjes fazore. Për më tepër, ai jep udhëzime për zgjedhjen e pajisjeve elektrike dhe rezistencën e tyre ndaj ndikimeve të jashtme (veçanërisht IP e mbrojtjes nga depërtimi). Përpara vënies në punë të makinës duhet të kryhen testet

elektrike të mëposhtme (duke siguruar gjurmueshmërinë dhe përsëritshmërinë e provave) dhe të regjistruara në DTN:

- 01.** Testi i vazhdimësisë së qarkut të sigurisë;
- 02.** Testi i rezistencës së izolimit;
- 03.** Testi i forcës dielektrike;
- 04.** Rryma e rrjedhur;
- 05.** Testi i performancës së sistemit të kontrollit.

2.6 Kriteret e tjera kryesore të sigurisë

2.6.1

Zjarri dhe shpërthimi

Makina e destinuar për t'u përdorur në Mjedise Potencialisht Shpërthyes (MPSH) duhet të jetë në përputhje me direktivën ATEX. Ky është gjithashtu rasti kur makina nuk funksionon në mjedis MSh, por përfshin një ose më shumë komponentë që përmbajnë

mjedis shpërthyes (për shembull: kabina e ngjyrës). Komponenti(ët) në fjalë do të jenë të vërtetuara sipas ATEX.

Sistemet për mbrojtjen nga zjarri duhet të merren parasysh nëse makina përdoret në një mjedis me mundësi të përhapjes së zjarrit.

2.6.2

Zhurma dhe dridhja

Përcaktohen projektimi dhe masat për emetimin e ulët të zhurmës në burimet e zhurmës (përdorimi i jometaleve, shmangia e rezonancës, projektimi i silenciatorëve të zhurmës, projektimi i përshtatshëm i kanaleve dhe tubave, etj.). Edhe pse MD nuk vendos asnjë kufizim të zhurmës, është e qartë se makineritë me emetim të ulët të zhurmës janë të shëndetshme për t'u përdorur për shkak të stresit më të ulët mendor. Përdoruesit duhet të informohen për vlerat aktuale të emetimit

të zhurmës (në manual), nëse emetimi i zhurmës tejkalon 70 dB(A). Përdoruesit duhet t'i përshkruhen një PPM të përshtatshme për mbrojtjen e veshit.

Përcaktohet gjithashtu dizajni me dridhje të ulët të makinerive (të mbajtura me dorë ose të drejtuara). Kur niveli i dridhjeve kalon 2,5 m/s², niveli aktual i dridhjeve duhet të tregohet në manual.

2.6.3

Rrezatimi

Disa makineri përdorin për funksionimin e tyre vetitë e fushave elektromagnetike (EM), rrezet X, rrezet Y, lazer etj. Në Direktivën për makineritë parashihet që emetimet e këtyre rrezatimeve të kufizohen në masën funksionale vetëm për të mbrojtur përdoruesin nga çdo efekt i dëmshëm i

rrezatimit.

Përveç aspekteve të sigurisë, duhet të sigurohet pajtueshmëria me direktivën EMC. Pajtueshmëria me direktivën EMC do të thotë që makina në fjalë nuk lëshon rrezatime të dëmshme EM, si dhe është rezistente ndaj këtyre rrezatimeve EM.

2.6.4

Emetimi i ndotjes

Makineritë duhet të projektohen ashtu që të krijojnë sa më pak ndotje. Gazrat, pluhuri ose lagështia duhet të nxirren nga makina me anë të sistemeve të nxjerrjes që kapin substancat në filtra.

2.6.5

Mirëmbajtja e makinerive

Statistikat e ngjarjeve të dëmshme tregojnë një tendencë të rritjes së lëndimeve që ndodhin gjatë aktiviteteve të mirëmbajtjes. Meqenëse DM parasheh masa për të gjitha ciklet e jetëgjatësisë së makinës, mirëmbajtja e sigurt duhet të jetë gjithmonë në mendje të çdo projektuesi. Vendosja, servisimi ose riparimi, pastrimi dhe mirëmbajtja duhet të jetë i mundur vetëm në kushtet e ndalimit ose shpejtësisë së ulët të kontrolluar dhe jo kur makina funksionon normalisht.

Kriteret e tjera i referohen llojeve të ndryshme të makinerive ose rrezeqeve specifike:

01. Makineri për lëndët agrourbushqimore, makineri portative me dorë dhe/

ose të drejtuara me dorë, makineri për punimin e drurit dhe materialeve analoge, makineri portative fiksuese dhe goditjeje, makineri për aplikimin e pesticideve;

02. Makineri mobile;

03. Makineritë e funksionimit të ngritjes;

04. Makineri pune për nentokë;

05. Makineri për ngritjen ose lëvizjen e personave;

06. Udhëzime të përgjithshme përdorimin e pajisjeve mbrojtëse dhe të sigurisë.

2.6.6

Makineritë mobile

Makineritë e lëvizshme (si makineritë e ndërtimit, makineritë bujqësore, etj.) duhet të plotësojnë kriteret shtesë kundër ngjarjeve të dëmshme të shkaktuara nga makineritë lëvizëse:

01. Ergonomia në vendin e punës;

02. Sistemi i kontrollit për manovrim;

03. Mbrojtja nga rreziqet mekanike;

04. Mbrojtja kundër rrezeqeve të tjera;

05. Treguesit;

06. Shënjimi.

2.6.7 Pajisje ngritëse

Në kriteret shtesë parashihen dispozitat për:

- 01. Stabilitet;
- 02. Manovrim;
- 03. Forcë mekanike;
- 04. Litarë, zinxhirë dhe rripa;

- 05. Pajisje ndihmëse ngritëse;
- 06. Kontrolle;
- 07. shënjim.

Po ashtu, duhet të kryhen testet e ngarkesës dinamike dhe statike.

2.6.8 Pajisje ngritëse për persona

Makineritë e përdorura për ngritjen e mallrave mund të përdoren edhe për ngritjen e personave. Kriteret e ngjashme zbatohen si më parë me theks të veçantë në rrezikun e mundshëm të rënies nga lartësia. Nëse funksioni i lëvizshmërisë së makinës është i pranishëm gjatë punës së ngritjes, atëherë këto dy lëvizje duhet të koordinohen në një

mënyrë pune të sigurt.

Makineritë e përdorura nën tokë duhet të projektohen, prodhohen dhe testohen në kushte të përdorimit të sigurt në zona të mundshme zjarri ose shpërthyes.



2.7 Vlerësimi i rrezikut

Siç u argumentua më herët dhe për shkak të faktit se të njëjtat rreziqe mund të shfaqen në pjesë të ndryshme të makinës në fjalë ose mund të ketë një kombinim rreziqesh në një pikë, një qasje e preferuar për analizën gjithëpërfshirëse dhe sistematike të sigurisë është realizimi i procedurës së vlerësimit të rrezikut, siç përshkruhet në EN ISO 12100.

Një arsye tjetër për këtë qasje është se rreziku sipas definicionit është një kombinim i probabilitetit dhe ashpërsisë së lëndimit ose dëmtimit të mundshëm të shëndetit në një situatë të rrezikshme. Meqenëse rreziqet dhe rreziqet e përgjithshme të lidhura me makinat renditen në Aneksin I të DM-së, por duhet të vlerësohen për të vlerësuar nevojën për masa sigurie, sipas EN ISO 12100 me një metodologji bazë për vlerësimin e rrezikut krijojet një bazë më e mirë për justifikimin e masave të sigurisë.

Standardi EN ISO 12100 jep parimet bazë dhe detajet mbi procedurën e vlerësimit të rrezikut. Ky është një hap thelbësor i projektuesit për të siguruar përputhjen e makinës me EHSR-të e DM-së.

Në këtë Standard përfshihet si në vijim:

- 01.** Lista e rreziqeve dhe situatave të rrezikshme që mund të shfaqen (Shtojca B);
- 02.** Lidhjet ndërmjet EHSR-ve nga Shtojca I e DM-së dhe llojet e rreziqeve dhe situatave të rrezikshme, si dhe lidhjet me standardin bazë për dizajn të sigurt EN ISO 12100;
- 03.** Parimet për vlerësimin e rrezikut dhe vlerësimin e masave të ndërmarra;

- 04.** Parimet për përgatitjen e standardeve të harmonizuara në mbështetje të DM-së.

Me fjalë të tjera, vlerësimi i rrezikut është një procedurë përsëritëse ku projektuesi:

- 01.** Përcakton qartë fushëveprimin dhe kufijtë e vlerësimit të rrezikut;
- 02.** Identifikon sistematikisht rreziqet ose situatat e rrezikshme dhe rreziqet që lidhen me to në lidhje me përdorimin e synuar të makinës dhe kush mund të lëndohet (përdoruesi, prona, natyra, etj.);
- 03.** Vlerëson ashpërsinë dhe probabilitetin e një ngjarjeje të dëmshme (metodologjia nuk është e specifikuar, por ISO/TR 14121-2: 2012 Siguria e makinerive — Vlerësimi i rrezikut — Pjesa 2: Udhëzimet praktike dhe shembujt e metodave jep një shembull të mirë të metodologjisë së detajuar);
- 04.** Vlerëson masat ekzistuese të kontrollit dhe (pa)mjaftueshmërinë e tyre për të arritur nivelin e pranueshëm të rrezikut (përputhshmërisë);
- 05.** Zgjedh dhe zbaton masat e sigurisë për eliminimin ose zvogëlimin e rreziqeve të papranueshme në një proces projektimi me tre hapa (parashikohet përdorimi i zgjidhjeve teknike nga standardet e harmonizuara);
- 06.** Vlerëson përmbushjen e EHSR-ve ose pajtueshmërinë me DM-në.
- 07.** Dokumenton rreziqet e identifikuara, vlerësimet e rrezikut dhe masat e rekomanduara të kontrollit, si dhe komunikimin e rreziqeve të mbetura

me përdoruesit;

- 08.** Rishikon dhe përditëson rregullisht vlerësimin e rrezikut për të llogaritur ndryshimet në aktivitet, proces ose faktorë të jashtëm.

Mos harroni se vlerësimi i rrezikut është një proces përsëritës që duhet të kryhet në intervale të përshtatshme ose kur ndodhin ndryshime të rëndësishme. Ai kërkon monitorim dhe rishikim të vazhdueshëm për të siguruar që masat e kontrollit janë efektive


dhe që rreziqet të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme.

Në përgjithësi, rreziku i lidhur me një rrezik specifik është një kombinim i:

01. Ashpërsisë (S);

02. Probabilitetit të ngjarjes së rrezikshme.

Të dy këta faktorë përcaktojnë nivelin e vlerësuar të rrezikut.



Parimi i vlerësimit të rrezikut (EN ISO 12100)

2.7.1

Vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut është procesi i vlerësimit dhe përcaktimit sasior të nivelit të rrezikut të lidhur me një rrezik specifik ose grup rreziqesh. Ai përfshin vlerësimin e mundësisë ose probabilitetit të ndodhjes së një ngjarjeje të rrezikshme dhe pasojave ose ndikimeve të mundshme nëse ngjarja do të ndodhte.

Përcaktimi i probabilitetit - mund të bazohet në të dhënat historike, gjykimin e ekspertëve, analizat statistikore ose informacione të tjera relevante. Merrni parasysh faktorë të tillë si shpeshtësia e ekspozimit ndaj rrezikut, mundësia për të zbuluar dhe shmangur atë dhe besueshmëria e masave të kontrollit.

Vlerësimi i pasojave të padëshiruara – vlerësohen pasojat ose ndikimet e mundshme që mund të rezultojnë nga ngjarja e rrezikshme. Kjo përfshin marrjen parasysh të ashpërsisë së dëmit ndaj njerëzve, pronës ose mjedisit. Pasojat mund të variojnë nga lëndime të lehta ose dëmtimet deri në ngjarje katastrofike me humbje të konsiderueshme të jetës ose dëme të përhapura mjedisore. Merrni parasysh pasojat e menjëhershme dhe afatgjata.

Vlerësimi cilësor - kryeni një vlerësim cilësor duke caktuar përshkrues cilësorë për probabilitetin dhe pasojat. Kjo mund të përfshijë përdorimin e shkallëve të tilla si të ulëta, të mesme ose të larta për të përshkruar gjasat ose ashpërsinë e dëmit. Kjo siguron një kuptim cilësor të nivelit të rrezikut dhe ndihmon në priorizimin e përpjekjeve për zbutjen e rrezikut.

Kombinoni probabilitetin dhe pasojat - kombinoni vlerësimet e probabilitetit dhe pasojave për të përcaktuar nivelin e përgjithshëm të rrezikut. Kjo mund të bëhet përmes një matrice rreziku, ku vlerësimet e gjasave dhe ashpërsisë vizatohen në një matricë për të përcaktuar vlerësimin e rrezikut. Matrica mund të ndahet në zona rreziku (p.sh. "hartat e nxehtësisë") ose nivele, të tilla si të ulëta, të mesme, të larta ose duke përdorur një shkallë numerike.

Raporti teknik ISO/TR 14121-2, që përdoret shpesh në sektorin e makinerive, jep shembuj të qasjes cilësore dhe sasore për vlerësimin e rrezikut dhe përcaktimin e niveleve të rrezikut.

Matrica e vlerësimit të rrezikut (ISO/TR 14121-2:2012, Tabela 1)


Mundësia e ndodhjes së dëmit (EN ISO 12100:2010,5.5.2.3)	Shkalla e dëmit			
	Katastrofik	I rëndë	Mesatar	I vogël
Shumë e madhe	E lartë	E lartë	E lartë	Mesatare
E madhe	E lartë	E lartë	Mesatare	E ulët
E vogël	Mesatare	Mesatare	E ulët	E papërfillshme
Shumë e vogël	E ulët	E ulët	E papërfillshme	E papërfillshme

Matrica e vlerësimit të rrezikut

Rishikimi dhe përditësimi – në përgjithësi, vlerësimi i rrezikut nuk është një aktivitet që bëhet vetëm një herë. Duhet të kryhet të paktën para dhe pasi masat e sigurisë (kontrollit) të zbatohen për të zbutur rrezikun. Rishikimi i rregullt dhe përditësimi i vlerësimeve të rrezikut do të bëhet kur informacioni i ri bëhet i disponueshëm, kushtet ndryshojnë ose identifikohen rreziqe të reja.

Probabiliteti mund të përkufizohet më tej si një kombinim i:

- 01.** Shpeshtësisë dhe kohëzgjatjes së ekspozimit ndaj një situatë ose rreziku të rrezikshëm (F);
- 02.** Probabilitetit të shfaqjes së një rreziku ose një ngjarjeje të rrezikshme (P); dhe
- 03.** Mundësisës për të kufizuar ose shmangur një ngjarje të dëmshme (W).



Rreziku është një funksion i ashpërsisë dhe probabilitetit të ndodhjes.

Një ngjarje e dëmshme mund të vlerësohet në këndvështrimin e natyrës së dëmit të mundshëm (përdoruesit, pronën, kafshët, mjedisin), llojin e lëndimit dhe shtrirjen (një ose më shumë persona).

Ashpërsia (S):

- 01.** S0 - pa rrezik;
- 02.** S1- lëndim i lehtë (i shërueshëm/riparueshëm);
- 03.** S2- lëndim i rëndë (i pashërueshëm/pariparueshëm),
- 04.** S3- vdekje (ose lëndim shumë i rëndë).

Koha ose shpeshtësia, kur përdoruesi është i ekspozuar ndaj një rreziku të caktuar ose situatë të rrezikshme (si mirëmbajtje, punë normale, punë provë) mund të japë një vlerësim për kohëzgjatjen e ekspozimit (F):

- 01.** F1 – rrallë; dhe
- 02.** F2- shpesh ose gjithmonë.

Parametri P (mundësia për të kufizuar ose shmangur ngjarjen e dëmshme) përfshin të dhëna për përvojat dhe trajnimet e punës, shpejtësinë e ngjarjes së rrezikshme, disponueshmërinë e çdo lloj paralajmërimi, mundësinë e tërheqjes në kohë nga zona e rrezikshme dhe mund të jetë:

- 01.** P1 - e mundur;
- 02.** P2- e mundur në kushte të caktuara; dhe
- 03.** P3- e pamundur.

Parametri W (mundësia për të kufizuar ose shmangur ngjarje të dëmshme) jep një vlerë që përshkruan aksidente të njohura ose ngjarje të dëmshme të regjistruara tashmë në të kaluarën (statistikat e aksidenteve) ose mund të krahasohet me makineri të ngjashme:

- 01.** W1 - e ulët;
- 02.** W2 - e mesme; dhe
- 03.** W3- i lartë.

2.7.2

Identifikimi i rrezikut

Për llojet e makinerive të përdorura gjerësisht, standardet e produktit janë zhvilluar, ku një listë e rreziqeve që lidhen me një lloj specifik makinerie është një pjesë e detyrueshme e një standardi të tillë.

Ndryshe është situata me makineritë për përdorim të njëhershëm, pasi nuk ekzistojnë standarde produkti për të. Identifikimi i rreziqeve është një hap fillestar në vlerësimin e rrezikut dhe duhet të përfshijë tërësisht të gjitha ciklet e jetëgjatësisë së makinerisë, si dhe origjinën dhe natyrën e rreziqeve.

Fillimisht duhet të ndodhë në fazën e hershme të projektimit të makinës dhe preferohet të rivlerësohet kur makina është ndërtuar fizikisht për shkak të faktit se ndonjëherë është e vështirë të parashikohen të gjitha ndërveprimet midis operatorëve/personelit të mirëmbajtjes dhe makinës. Kryerja e një kontrolli fizik të plotë të makinës dhe mjedisit të saj të punës është gjithashtu një detyrë me rastin e dorëzimit të makinës tek përdoruesit. Shikoni për ndonjë shenjë të dukshme rreziku, si për shembull instalime elektrike të ekspozuara, dysheme të rrëshqitshme, makineri të pambrojtura ose objekte të mprehta. Kushtojini vëmendje faktorëve mjedisorë, të tillë si ndriçimi i dobët, ajrimi i pamjaftueshëm ose zhurma e tepërt, të cilat gjithashtu mund të përbëjnë rreziqe.

Në këtë drejtim, standardi EN ISO 12100 mund ta bëjë identifikimin shumë më të lehtë pasi përmban në Aneksin B një listë kontrolli të të gjitha rreziqeve të mundshme

që mund të ndodhin me makineri. Një praktikë e mirë është që identifikimi i rrezikut duhet të jetë një detyrë ekipore, në mënyrë që të parandalohet anashkalimi i rreziqeve të caktuara ose të ketë mendime të ndryshme për trajtimin e tyre. Përveç projektuesit të makinës, pala e përdoruesit duhet të marrë pjesë gjithashtu në detyrën për të marrë parasysh faktorët njerëzorë si lodhja, ergonomia, stresi, shpërqendrimet dhe gabimet njerëzore që mund të kontribuojnë në rreziqe.

Në sektorin e makinerive industriale, janë zhvilluar metoda të avancuara të standardizuara, të tilla si Studimi i Rrezikut dhe Funksionalitetit (HAZOP), Analiza e Mënyrave dhe Efekteve të Dështimit (FMEA), ose Analiza e Pemës së Gabimeve (FTA) për të adresuar çështjet e sigurisë/cilësisë në një mënyrë shumë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse. Vëmendje e veçantë gjithashtu i kushtohet sigurisë funksionale të makinerive.

2.7.3

Siguria funksionale e makinerisë (projektimi dhe vërtetimi)

Siguria funksionale e makinerive i referohet aftësisë së një makine për të operuar në mënyrë të sigurt, edhe kur gjërat shkojnë keq, duke zbutur rreziqet që lidhen me përdorimin e saj të synuar. Këtu parashihet zbatimi i masave të sigurisë përmes pjesëve të lidhura me sigurinë të sistemit të kontrollit për të siguruar që makina të funksionon siç synohet dhe të mos paraqet rreziqe të paarsyeshme për operatorët, personelin e mirëmbajtjes ose individë të tjerë në afërsi të saj. Hapat e mëposhtëm duhet të ndërmerren për të adresuar sigurinë funksionale:

Hapi 1 – Identifikoni dhe përcaktoni funksionet e sigurisë që makineria duhet të kryejë për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet. Funksionet e sigurisë janë veprime ose veçori të krijuara për të zbuluar, parandaluar ose zbutur situata të rrezikshme. Ato përfshijnë elementin hyrës – njësinë logjike – elementin dalës. Shembujt përfshijnë:

- 01.** Elementet hyrëse: sensorë, butoni emergjence, kyçje, zbulim opto-elektronik, etj;
- 02.** Njësitë logjike: reletë e sigurisë, kontrolles logjik të programueshëm, etj;
- 03.** Elementet e daljes: ndërprerësit, valvulat e mbylljes, frenat, etj.

Përcaktoni objektiva specifike sigurie për çdo rrezik që duhet adresuar. Këto objektiva duhet të përshkruajnë rezultatin e dëshiruar të sigurisë, si p.sh. "Parandalimi i ndezjes së paqëllimshme të makinës" ose "Zbulimi dhe ndalimi i rritjes së presionit të tepërt". Çdo objektiv sigurie duhet të jetë i matshëm dhe i arritshëm.

Hapi 2 – Përcaktoni nivelin e nevojshëm të performancës (PL) që duhet të arrihet në lidhje me nivelin e vlerësuar të rrezikut. Niveli i performancës së përcaktuar do të ndikojë në arkitekturën e sistemit të kontrollit (një kanal ose tepricë) dhe kërkesat e besueshmërisë për zgjedhjen e komponentëve të sigurisë.

Nivelet e Performancës (NP) variojnë nga NP a (më e ulët) deri në NP L (më e larta), ku secili nivel përfaqëson një nivel të ndryshëm të reduktimit të rrezikut dhe besueshmërisë së funksionit të sigurisë.

Shënim 1: Tepricë - një sistem kontrolli, ku një qark monitorohet nga një tjetër dhe anasjelltas. Kur në sistem shfaqen vlera të ndryshme, atëherë duhet të jepet një sinjal për mosfunksionim. Sistemi i kontrollit duhet të marrë masat e nevojshme si dështimi i komponentit në sistemin e kontrollit që shkakton masat vijuese të sigurisë (për shembull: ndalimi - shkëputja e furnizimit - parandalimi i ndezjes së papritur).

Shënim 2: Mbulimi diagnostikues i sistemit të kontrollit – gjatë kryerjes ciklike ose të vazhdueshme të funksioneve të sigurisë, po monitorohet funksionimi i duhur i pjesës së sistemit të kontrollit të lidhur me sigurinë. Nëse gjatë monitorimit ndodh një dështim, defekti zbulohet dhe makina duhet të ndalet në mënyrë të sigurt automatikisht. Kategoria më e lartë e sistemit të kontrollit (dmth. Niveli i Performancës e) mund të merret me kombinimin e tepricës, komponentëve të besueshëm dhe mbulimit diagnostik. Në këtë rast, një dështim në qarkun e kontrollit do të zbulohet gjatë vetë monitorimit dhe humbja e një kanali kontrolli do të zëvendësohet nga kanali i tepërt.

Hapi 3 – Zgjidhni dhe inkorporoni pjesë dhe përbërës të lidhur me sigurinë që plotësojnë Nivelet e kërkuara të Integritetit të Sigurisë (NIS) ose Nivelet e Performancës (NP). Këto pjesë dhe përbërës duhet të kenë besueshmëri të mjaftueshme dhe karakteristika funksionale për të kryer funksionet e synuara të sigurisë.

Si rregull i përgjithshëm, përdorni komponentë të certifikuar – merrni parasysh përdorimin e komponentëve që janë të certifikuar ose të projektuar posaçërisht për aplikime sigurie. Kërkoni për komponentë që i janë nënshtruar vlerësimeve të sigurisë, të tilla si ato me vlerësime NIS ose NP. Këta komponentë janë projektuar dhe testuar posaçërisht për të përmbushur standardet e kërkuara të sigurisë dhe për të ofruar performancë të besueshme.

Kushtojini vëmendje besueshmërisë dhe aftësie diagnostikuese – sigurohuni që komponentët e përzgjedhur të kenë besueshmërinë dhe aftësitë e nevojshme diagnostikuese për të kryer funksionet e synuara të sigurisë. Komponentët duhet të jenë në gjendje të zbulojnë defekte, dështime dhe keqfunksionime, dhe të ofrojnë reagime të përshtatshme diagnostikuese, nëse është e nevojshme. Rishikoni dokumentacionin teknik të ofruar nga prodhuesit e komponentëve. Sigurohuni që dokumentacioni të përfshijë informacione përkatëse të lidhura me sigurinë, të tilla si shkallët e dështimit, mbulimi diagnostik dhe çdo kërkesë specifike për instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen.

Hapi 4 – Siguroni përputhjen me standardet dhe rregulloret përkatëse të sigurisë të zbatueshme për makinerinë. Standardet si ISO 13849 (Siguria e Makinerisë – Pjesët e sistemeve të kontrollit të lidhura me sigurinë) dhe IEC 61508 (Siguria funksionale e sistemeve elektrike/elektronike/të programueshme që lidhen me sigurinë) ofrojnë udhëzime për projektimin (llogaritjen), zbatimin dhe verifikimin (vërtetimin) e funksioneve të sigurisë.

Sigurohuni që funksionet e sigurisë të jenë të integruara dhe të pajtueshme me modelin e përgjithshëm të makinës. Merrni parasysh faktorë të tillë si sistemet kryesore të kontrollit dhe rrjetet e komunikimit të nevojshëm për të zbatuar funksionet e sigurisë në mënyrë efektive.

Është e rëndësishme të theksohet se procesi i përcaktimit të nivelit të kërkuar të performancës mund të jetë kompleks dhe mund të kërkojë ekspertizë në vlerësimin e rrezikut, standardet e sigurisë dhe sigurinë funksionale. Përfshirja e profesionistëve ose konsulentëve me njohuri në këtë proces mund të ndihmojë të sigurohet që përcaktimi i Nivelit të Performancës është i saktë, i besueshëm dhe në përputhje me kërkesat e zbatueshme.

Hapi 5 – Kryeni verifikimin dhe vërtetimin e plotë të funksioneve dhe sistemeve të sigurisë. Kjo përfshin testime, inspektime dhe analiza për të siguruar që masat e sigurisë funksionojnë në mënyrë korrekte dhe efektive duke reduktuar rreziqet e identifikuara. Kryeni inspektime dhe mirëmbajtje periodike për të garantuar sigurinë e vazhdueshme funksionale.

Hapi 6 – Përgatitja e dokumentacionit të qartë dhe gjithëpërfshirës në lidhje me sigurinë funksionale të makinerisë. Kjo përfshin manualët e sigurisë, procedurat e funksionimit, udhëzimet e mirëmbajtjes dhe materialet e trajnimit për operatorët dhe personelin e mirëmbajtjes. Jepni udhëzime të qarta për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zgjidhjen e sigurt të makinës.

2.7.4

Dallimi midis rrezikshmërisë dhe rrezikut

Rrezikshmëria dhe rreziku janë dy koncepte të lidhura, por të dallueshme në kontekstin e vlerësimit të sigurisë dhe rrezikut. Këtu është ndryshimi midis rrezikshmërisë dhe rrezikut:

Rrezikshmëri: Një rrezikshmëri i referohet një burimi të mundshëm dëmi, rreziku ose efekti negativ. Është një gjendje, substancë, aktivitet ose situatë që ka potencialin të shkaktojë dëm për njerëzit, pronën ose mjedisin. Rrezikshmëria mund të jenë fizike (p.sh. pjesët lëvizëse të makinerive, çlirimet e energjisë, etj.), elektrike, termike, biologjike (p.sh. agjentë infektivë), kimikë (p.sh. substanca toksike), të sjelljes (p.sh. praktika të pasigurta të punës), etj. Rrezikshmëria ekziston pavarësisht nëse paraqet rrezik të menjëhershëm apo jo.

Rreziku: Rreziku, nga ana tjetër, paraqet gjasat ose probabilitetin që një rrezik të shkaktojë dëm ose pasoja negative. Ai përfshin mundësinë për të ndodhur një ngjarje

e padëshiruar dhe ashpërsinë e ndikimit të saj. Rreziku është një kombinim i mundësisë së ekspozimit ndaj një rrezikshmërie dhe pasojave të mundshme nëse ai rrezik realizohet. Vlerësimi i rrezikut përfshin vlerësimin e mundësisë dhe ashpërsisë së mundshme të dëmit që rezulton nga ekspozimi ndaj një rrezikshmërie.

Në përmbledhje, një rrezikshmëri i referohet potencialit për dëm ose rrezik, ndërsa rreziku përfshin gjasat dhe ashpërsinë e dëmit që rezulton nga ekspozimi ndaj një rrezikshmërie. Vlerësimi i rrezikshmërisë identifikon burimet e mundshme të dëmtimit, ndërsa vlerësimi i rrezikut vlerëson probabilitetin dhe pasojat e këtij dëmi. Vlerësimet e rrezikshmërisë dhe ato të rrezikut janë thelbësore për menaxhimin efektiv të sigurisë dhe zbatimin e masave të përshtatshme për zbutjen e rrezikut (kontrollet e rrezikut).



3. Roli i standardeve në dizajnin e makinave



3.1 Pasqyrë e përgjithshme

Standardet e harmonizuara luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e konformitetit të makinerive. Kur përdoren dhe zbatohen tërësisht në procesin e projektimit, ndërtimit dhe vlerësimit të konformitetit të makinës, ato japin supozimin e konformitetit me dispozitat e direktivës(ve).

Përdorimi i standardeve të harmonizuara nuk është i detyrueshëm. Sidoqoftë, kjo rekomandohet pasi është mënyra më e lehtë për të arritur pajtueshmërinë me EHSR-të. Domethënë, EHSR-të e DM-së (Aneksi I) nuk japin zgjidhje teknike për përmbushjen e tyre. Në mbështetje të mirëkuptimit të tyre të barabartë dhe për të vendosur një nivel minimal të gjendjes së teknologjisë në sektorin e makinerive, komisioni i BE-së ka urdhëruar zhvillimin e standardeve të shumta në CEN (Komiteti Evropian i Standardizimit)

që do të japin kërkesa minimale teknike për të gjitha fazat e ciklit të jetëgjatësisë së:

- 01.** Montimi dhe çmontimi;
- 02.** Vendosja;
- 03.** Përdorim normal;
- 04.** Mirëmbajtje;
- 05.** Transport.

Standardet e harmonizuara po zhvillohen vazhdimisht. Standardet ekzistuese ndryshojnë, shfaqen standarde të reja, disa nga standardet ekzistuese i nënshtrohen klauzolave mbrojtëse, etj. Kështu që prodhuesit pritet të ndjekin ndryshimet në standardizimin e produkteve të tyre.

3.2 Llojet e standardeve

Për shkak të shumëllojshmërisë së madhe të makinerive (shumë prej tyre janë unike) nuk është e mundur të bëhen standarde (produkti) për çdo lloj makinerie. Prandaj, standardet për sigurinë e makinerive bëjnë një sistem unik të përbërë nga tre lloje të ndryshme:

01. Lloji A (standardet bazë): jepni vetëm udhëzime për projektuesit se si t'i qasen strategjisë së sigurisë në fazën e projektimit të makinës.


02. Lloji B (standardet e grupit):

■ Lloji B1 përcakton kërkesat për aspekte të ndryshme të sigurisë (për shembull: distancat e sigurisë, temperaturat e lejuara

të sipërfaqes, kufijtë e zhurmës, ergonomia, etj.),

